

DOCUMENT RESUME

ED 176 565

PL 010 634

TITLE Albanian Song Book.
 INSTITUTION Defense Language Inst., Monterey, Calif.
 PUB DATE Feb 65
 NOTE 88p.; For related documents, see FL 010 626-628 and
 FL 010 637-648
 AVAILABLE FROM Defense Language Institute, Foreign Language Center,
 Nonresident Instruction Division, Presidio of
 Monterey, California 93940
 LANGUAGE Albanian
 EDRS PRICE MF01/PC04 Plus Postage.
 DESCRIPTORS Adult Education; *Albanian; Audibilingual Methods;
 Childrens Games; Choral Music; Classroom Materials;
 *Folk Culture; *Instructional Materials; *Language
 Instruction; *Music; Poetry; *Second Language
 Learning; Supplementary Textbooks; Uncommonly Taught
 Languages

ABSTRACT This Albanian song book contains folk songs,
 patriotic songs, love songs, children's games and a few poems. The
 music to some of the songs is included. (NCR)

 * Reproductions supplied by EDRS are the best that can be made *
 * from the original document. *

ALBANIAN

SONG BOOK

FEBRUARY, 1965

U.S. DEPARTMENT OF HEALTH,
EDUCATION & WELFARE
NATIONAL INSTITUTE OF
EDUCATION

THIS DOCUMENT HAS BEEN REPRODUCED EXACTLY AS RECEIVED FROM THE PERSON OR ORGANIZATION ORIGINATING IT. POINTS OF VIEW OR OPINIONS STATED DO NOT NECESSARILY REPRESENT OFFICIAL NATIONAL INSTITUTE OF EDUCATION POSITION OR POLICY.

PERMISSION TO REPRODUCE THIS MATERIAL HAS BEEN GRANTED BY

Robert P. Schoffman
DLIFLC

TO THE EDUCATIONAL RESOURCES INFORMATION CENTER (ERIC).




ED176565

FL010634

DEFENSE LANGUAGE INSTITUTE

DEFENSE LANGUAGE INSTITUTE

This pamphlet is for use by the faculty, staff and students of the Defense Language Institute solely for official purposes. It is NOT for general distribution. It may NOT be released to other persons, quoted or extracted for publication, or otherwise copied or distributed without specific permission in each instance from the Director, Defense Language Institute.




ROY M. KESSLER
Colonel, USA
Director

ALBANIAN SONG BOOK

**Folk, Patriotic, Love Songs,
Childrens' games, and a few Poems**

Collected by:

THE ALBANIAN LANGUAGE DEPARTMENT



Hymni i Flamurit

Rreth Flamurit të përbashkuar

Me një dëshirë me një qëllim

Të gjithë atje duke u-betuar

Të lidhim besën për shpëtim.

Nga lufta veç ay largohet

Që është lindur trathëtor,

Kush është burrë nuk frigohet,

Po vdes, po vdes si një dëshmor.

Në dorë armët do t'i mbajmë,

Të mprojm' Atdhënë në çdo kënd,

Të drejtat tona ne s'i ndajmë,

Armiqtë s'kanë këtu vënd.

Se Zoti vetë e thá me gojë,

Që kombet shuhen përmbi dhe

Por Shqipërija do të rrojë,

Për të, për të luftojmë ne.

SHQIPNIA

Edhe hana do t'va dije,
Edhe dielli do t'kët pa,
Se përçark ksaj rrokullije,
Si Shqipnija 'i vend nuk ka!

Shkunde pluhnin pra, o Shqipni!
Ngrehe ballin si mbretneshtë !
Se me djelm që ushqen ti në gjí,
Nuk mund t'cuhesh jo robneshtë !

Mbi ato male e bjeshkë kreshnike,
Lejnë mande' ata djelm si Zana,
Arm't e t'cilve, p'rherë besnike,
Janë përmendë ndër fise t'tana.

Shkunde pluhnin pra,.....

Atje lejnë, po, Toskë e Gegë,
Si dý rreze n'flakë t'njij dielli:
Si dý rrafe, që shkojnë tue djegë,
Kur s'trepë rëja nalt prej qielli.

Shkunde pluhnin pra,.....

Shqipnis së Robnueme

Oh, moj Shqipni, e mjera Shqipni,
Kush të ka qitë me krye në hi ?
Ti ke pas' qenë një zojë e rëndë,
Burrat e dheut të thirrshin Nënë.

Por, sot, Shqipni, më kallxo, si je ?
Si një lis i rrëxuem përdhë,
Shkon bota sipri e me kamb' të shklet,
E një fjal' t'ambël kush s't'a flet.

Kur ka lidh' besën hurri i Shqipnis,
I ka shti frigën gjithë Rumelis:
Ndër lufta t'rrepta gjithëkund ka rë,
Me faqe t'bardhë gjithëmonë është dë.

Por, sot, Shqipni,

Qysh prej Tivarit deri në Prevezë,
Gjithëkund lëshon dielli vapë o rrezë,
Asht toka jon' t'Par't na e kanë lënë,
Kush mos t'na prek', se vdesim t'tanë.

Por, sot, Shqipni,

A t d h e u

N'tý mendoj kur agon drita,
Kur bylbyli mallshëm këndon,
N'tý mendoj kur siset dita,
Terri botën kur e mblon.

Veç se tý të shof un' n'andërr,
Veç se tý çuet t'kam n'mendim;
Ndër të vështira ti m'je qandërr,
Për tý i lehtë m'vjen ç'do ndeshkim.

Pa tý lules s'm'i vjen era,
Pa tý pema fryt nuk m'bien,
Mue pa tý nuk m'del prendvera,
Pa tý dielli nuk m'shkëlqen.

Hymni i Djelmënis Shqiptare

Djelmëni, ti je gjithë ahpresa
E njëj hylli, që agon
E n'Shqipni sot po flakron !
Djelmëni, ti je qindresa
E Atdheut, kur n'luftë na fton.

Djelmëni, gjithmonë përpara
Për flamur dhe për Atdhë
Hurra djelm, ju dhashtë e mbara
N'paq e n'luftë kur Shqipja thurret !

Gjithkund toka është e jona
Ku kjo gjuhë e shejtë tingllon
E një gjak shqiptar vëlon.
Pra një Zot na tjetër s'drona
Kur në luftë Atdheu na fton !

Djelmëni, gjithmonë etj.

-Rueje, o Zot Atdhën!

Rueje, Zot, Atdhën e Prësin;

Fën e pesën na i mba n'cak

Mën kamb' t' huej mos na lsho fisin

Për pa derdhë në t'mbramin gjak.

Njikto male e zaje t'ona

T'per't na i lan' në trashigim:

Ktu me rrnue, ktu, edhe, t'e vona,

T'mbramin duem me pasë pushim.

Kush, pos nesh, ktu vend nuk ka;

Kamba e huej ktu s'ká pse shklet i

me gjak t'on' ky vend asht lá:

Vaj! p'r atë që na e përket!

Porsi fleta!...

Porsi fleta e Ejllit t'Zotit,
Po rref Flamuri i Shqipnis,
E thërret t'bijt e Kastriotit
Me u mbledh' tok me çetat e ushtrisë.

Bini, Tosk' e bini Gegë !
Si dy rrefë, që shkojn' tue djegë !
2 Bini, Lek' ! Bini Malsorë !
Trima, mbrend' ! me dor' ! me dorë !

Mbi njat Flamur Përendija
Me dor' t'vet Ai e ka shkruar:
"Për Shqiptar' do t'jet' Shqipnija
Kush e prek', ai qoft' mallkue!"

Bini, Tosk' e bini etj.

Të Gjithë Ne o Djema...

Të gjithë ne o djema
të japim dorën-e
se neve jemi shokë
2 me besë e dashuri.

Eja mblidhuni këtu, këtu, këtu
2 eja mblidhuni këtu, këtu
eja, eja mblidhuni këtu
bashkë me ne.

Se fjala jonë është
liri për Shqipëri
2 atëherë flamuri jonë
shkëlqen e mbretëron.


Eja mblidhuni.....etj.

Kuq e si

Fishk'illon veri, ushton duhija,
Bjeshkët për rreth mbushen me borë;
Por kjo stinë për në ë me orë,
Qysh se 'i lule me rritë desht:

Rriti lulen kuq e si,

Që ë më e buk'ra e kësaj Shqipëri.



Ngjyra e saj, njonsi prendvere,

Përtrin viset e Shqipërisë;

Lule ë kjo, lulja e lirisë,

Që në nderën n'vend na ë çon.

Të falen lule, kuq e si,

Si t'y s'rritë më kjo Shqipëri.

Kuq si gjaku, që përhera

N'dej t'Shqiptarvet idhtë pa vlusë.

Zi si futa, që pat mblusë

Njat annik qi me ë njoftë s'desht.

Të falen, lule kuq e si,

S't'ka kush, jo, posë kësaj Shqipërisë.

Malli për Atdhë

Ndër njikto vënde për bukuri,
Dhën t'em i shuemj jam tue dishrue;
N'qytete t'hueja, porsi n'shkroti;
Rrij tue gjimue.

A e bukur fusha kûr çilë orëndvëra,
Lulzim ka kopshëti kûr lulet dalin;
E drandofilles ndër fushë tret' era,
E përte malin.

Por gjith këto t'mira ngushllim nuk m'apin:
Për atdhë t'ëmin zëmra po m'shkrifhet;
Njatje kûr mendja lëshon ndo'j herë vrapin,
Shëndi përtrifhet.

Sa herë nën hije t'nji farë çinari,
Afer nji kroni që i shkon për bri,
Për vënd mendoheç, kû ndodha s'pari,
N'vaf tue u-shkri.

O bjeshk', o male, fusha t'bekueme;
Ku vetë herherna për shetë shkoshë;
O Maranaji, o Buan' e mbëlueme,
Me bimë gjelbroshe.



Nji Fatosi.....

Atje n'at vend të lamun,
me gjak t'Arbnorit trim;
atje një djalë është vramun;
atje mbet një Ilir.

Atje shqipja luftovi
trimnisht me zogjt e vet;
atje një zë ushtovi
në zjarr, se një na mbet.

Ai vend nuk do t'harrohet,
i gjallë do t'jetë për në;
mbas tashit do t'emnohet
një çerdhe e shoqes së ré.

Gjuha Shqipe

Porsi kanga e zogut t'verës,
Qi vallzon n'blerim të Prillit;
Porsi i ambli filladi i erës,
Qi imon gjit e drandafillit:
Porsi vala e bregut t'detit,
Porsi gjama e rrfës zhgjetare,
Porsi ushtima e nji termetit,
Njashtu â gjuha e jon' shqiptare.


Ah! po, â e ambël fjala e sajë,
Porsi gjumi nënji kërthi,
Porsi drita plot uzdajë,
Porsi gazi i pa mashtri;
Edhe ndiehet tue kumbue,
Porsi fleta e Kerubinit,
Ka' u bjen qiellvet tu' flutruë
N' t'zjarrrat, valle t'amëshimit.

Pra, mallkue njaj bir Shqipari,
Qi ket gjuhë të Perendis,
Trashigim, qi na la i Pari,
Trashigim s' i a lën aj fmis;
Edhe atij i u thaft', po, goja,
Qi e përbuz' ket Gjuh' hyjnore;
Qi n'gjuh' t'huej, kur s'âsht nevoja,
Flet e t'veten lën mbas dore!

Në gjuh' shqipe nanat t'ona
Shi prej djepit na kan' thânun,
Se âsht nji Zot, qi do t'a dona;
Njat, qi jetën na ka dhânun;
Edhe shqip na thân se Zoti
Për Shqiptar' Shqipnën e fali,
Se sa t'ëndën stina e moti,
Do t'a gzojn' kta djali' mbas djali.

Lantumirë

Lantumir' - vendet e mija,
Që, po shduken dal' - ngadalë;
Gjimon deti, ushton duhija,
Lkundet barka val' mbi valë;
Kah njëj diell, qi & tue flakue
Andej fill un tash do t'veta
Lantumir', o dhë i bekue
Lantumir', përse t'jët jeta,



E ato halë e qeparisa
Kam me i pas' ndër mend gjithëmonë,
E ato stane e njato mrisa,
E ato berre e ato kumbonë.....
Por, oh vaj malet e mija
Që, po shduken, dal' ngadalë;
Gjimon deti, ushton duhija,
Lkundet barka val' mbi valë.

I Tretuni

Nuk kalon nji nat' e n'andërr,
Porsi zhgjandërr,
E shof nanën ktu për bri;
Me krye vjerrt', me lot për sy
Kri tue shifrj
Njat idhnim qi don me e ngri.

Ndëjun m'duket prap te votra,
Ku me motra
N' drit' t'kandilit qepte e arnote;
Por njat gaz nuk ka qi i shndritte
Kur goditte
Petkat djalit e shëndote.

Kqyr njat vend ku mbramje rrishe
Kur nuk kishe
Fije idhnimit nepër ftyrë,
E ngurron si t'kënke gurit
E, pshtetë murit,
Lott i dalin rrkajë tue kqyrë.

E mandej si del nji krue
Tue bunue
Rreth e rreth prej brifes s'malit,
Rrkaj' i ulën lott për rrudha.
- Nuk është udha,
Nan', m'u idhnue, për t'zeza t'djalit.

Kur n'kët shekull n'drit' e qite,
Kur e rrite
Me njat mundë qi nep hitija,
*Nji nanë tjetër, thoshe, ke,
Bir, n'ket dhë,
Nana e jote ë Shqiptarija.

- Mend e zemër për të shkrijji,
E përtrijji
Nam ë lavd kur t'i vijë "dita".
Mbës fjal'sh t'tua përher' shkova,
E t'ndigjova;
Shqiptarin nuk e korita.

Bagëtija Në Kullosë

O ! sa bukurí ka tufa ! sa gaz bije bagëtija !
Vijnë posi blet' e plotë, i bekoftë Perendija !
Nepër shesh' e ndër bregore, janë përhapur shqerrat,
E këcërit nepër rripat, dhe në gjethet e në ferrat;
Sa me vrap e me gaz bredhin, edhe lozin shok-me-shok,
Aty përhapën me-nxit, aty mblidhen prap tok,
Edhe prap tufë-tufë, përhapën duke bredhur,
Duke ikur me vrap shumë, duke lojtur, duke hedhur,
Nxitojn' e s'lodhen kurr, edhe kur i merr urija,
Sicili futet në tufë, sulet në mëm' e 'tija;
Posa gjën mëmën e dashur, edhe me vrap i hyn në gji,
Rri në gjunjë dhe zë sisën e qumshtin e ëmbël pi:
Pa e ëma me mall shumë, ndo dhi qoftë e ndo dele,
Bir' e vetëm e merr në gji me gaz e me përkëdhele,
Sa të miratë ke dhënë ! Zot i math e i vërtetë !
E ç'nom të bekuar vure për çdo gjë q'është në jetë !
Sa më pëlqen blegërima, zer' i ëmbël i bagëtisë,
Qengji edhe kec' i bukur, që rri më gjunj' e pi sisë !
Përhapur bagëtija, nepër sheshë, nepër brinja,
Ndër lajthí e nepër dushnja, ndër murriza, në dëllinja,
Bijen zilet e këmborëdhe fyelli e xhuraja, ... etj.

Krenija

Po ti mos, moj flutur, mâ;
Mos u sjell aq rreth kandilit;
Rueju, kqyr; çka je tue bâ ?
A s'mendon se flaka djeg ?
Kish t'a dijshe pse t'a kande
At dritë t'rrëjshme qi t'kërcnohet;
Pse, tuj ndjekë at mänden t'ande,
Shkon e e vën vedin n'rrezik !
Hik, e mjerë, sa s'jë gandue,
Shporrju flaks' e del, ndër ara,
Ku ti mundesh me flutruë
Lule m' lule e gëmb mbi gëm.
Por, kuj i flet ? ... A s' t'thaç ? Qe mbete
Përcullue e coftë për dhë,
E, n'mâ t'mbramën fije jete,
Nxûne si krenija t'lshon.

D i m n i

Nepër fush' e nepër male

Fryn murrlani me stuhí;

O murrlâ, njat frymën ndale,

Ndal tí, o akull, mos me ngrí.

Mos m'a ngrini ket pik' gjak !

- Struku, struku, i shkreti plak.

Po del dimni me kos' n'dorë,

Gjeth e bër i ka kositë;

Qet balkoni pjesm e borë,

E plak-shkreta, tue mërdhitë

I thot' vedit me zâ pak:

- Struku, struku, i shkreti plak.

Foshnja Me Buzë Në Gaz

E kandshme është hëna
Kur del me zëna,
E në tokë me dritë përndaret.
Hyjzit që shndrisin.
E që shetisin
Nepër qiell, janë të bukur fare.


Kur del agimi,
E rruzullimi
Me të dritë kuqloshe mblohet
E përmbi kashta
Shndritë pika-lashta
Zemra për mall gazmohet.


Por s'i gjet qielli,
Nuk i gjet Prilli,
As fllad që shetitë lulet.
E me erna veshet,
Foshnjes që i qeshet
Nanës, kur mbi të përkulet.




Natë e Qetë

O, e qeta natë; o, e shëjta natë
Të gjithë po flëjnë, zogjët janë ratë
Veç Marija po rri çue
At fëmijë ari tue adhrue
Që prej qiellit për në
Dësh vorfnisht me lé.





K a n g ë



Natyra na fali 'imend pijen
Në tepri danton të rij edhe pleq
T'i a druem pra kësaj shokë edhe hijen
Për të rij nuk ka ves më të keq.



2 Pi, pi, pi lum vllau pi,
por për pa u-shty kurr në tepri !
2 Pini ju shokë dhe gësoniu në harë
të gëzojmë për këtë moshën e re.



A jé brynë, moj, a jé borë....

(Valle)

A jé brynë, moj, a jé borë ?

Moj e holla !

E bukura vetull hollë

Moj e holla !

E bukura kuq në faqe

Moj e holla !

Si hâna që shkrep në bahçe

Moj e holla !

E bukura sy' si hÿll

Moj e holla !

Kur m'a çilë e kur m'a mbyllë

Moj e holla !

Si hâna që shndritë në pyllë

Moj e holla !



Dasinger t' a fine

Andante

2/4 3/4 2/4 3/4

5 3/4 2/4

accell.

D.C.

Allegro

2/4 2/4 2/4 2/4

D.C. 5 x e fine

Fine



Dashnuer t'u bāna




2
Dashnuer t'u bāna
Unë t'y moj lule
Rrezet si hāna
N'zemër m'i prūne.

2
Të gëzojmë sa erdh-prendvera
Përsëri,
Për mbi gjitha lulet tjera,
2 Bashkë me t'y, moj drandofille
Do të rrij.

2
Prej s'larg m'shikjove
Si rrezja e diellit
Kur m'u afrove
Si engjëll qielli.

2
Tash sa kohë që s'jemi pamun
Na të mjerë,
Mos të rrim mē kështu tuj kjamun,
2 Avitu, o mori lule
Të marr erë.

Sa Bukur Rrojshim !



Sa bukur rrojshim, kur rrijshim bashkë !

Dashurin e kishim t'ambël shumë !

Smirë na kishin të gjithë bota;

2

kur na shikojshin bashkë të dy !



Tahti që u-larguem po dishrojmë !

Syt me lot të ngarkuem, jetën të shkurtueme

Der' sa të vijë ora e mirë,

2

Der' sa të të shof, mandej le të vdes !



Mueji i Májit



Sa i bukur ishte mueji i Májit
Kur dilshim bashkë rransës së malit
Pranë burimit rrijshim, ndigjojshim
A e mba mend sa bukur rrojshim ?

Nën ata lisa të bleruem
Luejshin bylbylat tue këndue
Të përçafuem rrijshim, andëtrojshim
A e mba mend sa bukur rrojshim.

Të vdisshe atëherë sa mirë qe
Në krahnuer tând kur bëjshe bé
E tue të puthë ti mue më thojshë
Jetën pa mue ti nuk e dojshe.

A do të vijë prap mueji i Májit
Të dalim përsri rransës së malit
Pranë burimit që të qëndrojmë
Dhe zemrat tona t'i bashkojmë.

Känge e Decis.

Allegro


2/4

Fine meno

2

D.C. e Fine


Kānga e Detit



O ti det-o ujë i njelmë
Që gjithëmonë u-gjete plot

A a a a a , aman-e


Shumë kërkuese fundi s'tu - gjet
Kur do të jetë mbarimi yt ?



Sa vaporre, sa gjemije
Mbi t'ý shkojnë e s't' bājnë zollum

A a a a a , aman-e

Ti ke hyqëm me i përpi
Por je i gjënë e duron shumë.




Kapiteni djal' i rí
Merr turbín e bān se jran

A a a a a , aman-e

Donë me m'dalun mendt prej kreje
Kur e shof tallazin tād.

Nën një mal e ndër dy ara

(Valle)




Nën një mal e ndër dy ara,
Mbjejl e korr, moj, vashë e bardha!
Bjen një plak-o aty pari:

--Puna e mbarë, s'zëzë, moj, vashë.
T'mbarë nos paç, o more, plak!
--A vij, vashë, e të ndimoj pak ?
Ndima e jote u-laftë me gjak !

Nën një mal e ndër dy ara,
Mbjejl e korr, moj vashë e bardha!
Bjen një djalë-o aty pari:

--Puna e mbarë, s'zëzë, moj, vashë.
Të mbarë paç, o more, djalë !
--A vij, vashë, e të ndimoj pak ?
Ne të ndimoftë i madhi Zot;
More djalë, a je martue ?
--S'jam fejuar as s'jam martue!
A t'a nap një tëme mbesë ?
--Shka t'a bëj qyqen e zezë ?
A t'a nap një tëme motër ?
--Shka t'a bëj qyqen në votër ?
More djalë, a më merr mue ?
--Të lumtë goja, mirë po thue !



E m i n j a

O, bânëm, Zot, bylbyl(o) mbi njat lis(e),
sa t'a shof Eminen, oh, tue qendisë(e).

O, Emine, hyje moj,
cucë e ré, ç' m'fike moj
O, ku m'a le, mori, besen(e) ?
Qafë për qafë na do të vdesim(e).



O, bânëm, Zot, bylbyl(o) mbi njat ftue(e),
sa t'a shof Eminen, në magje tue gatue(e).

O, Emine, etj.

O, bânëm, Zot, rrasë(o) për nën krue(e),
sa të vijë Eminja e të lajë mbi mue(e).

O, Emine, etj.



O, bânëm, Zot, bylbyl(o) mbi njat mollë(e),
sa t'a shof Eminen, oh në këmishë t'hollë(e).

O, Emine, etj.

Ch ! Po té Pres te Dega e Fikut.

Allegro


5/4 (2/4) | (3/4) | 4/4 (2/4) p (2/4) p | 5/4 (3/4) p p p. (2/4) p |

(2/4) (3/4) p | (2/4) | (3/4) | 4/4 (2/4) p (2/4) p | 5/4 (3/4) p p p. (2/4) p |

(2/4) (3/4) p | p || D.C.

Oh! Po të Pres te Dega e Fikut

1 Oh! Po të pres te dega e fikut,
2 moj zavalli unë;
2 Pse s'i a bân qejfin ashikut,
2 moj zavalli unë.



1 Oh! Po të pres te dega e mandit,
2 moj zavalli unë;
2 Pse s'ja bân qejfin këtij djalit,
2 moj zavalli unë.

1 Oh! Po të pres ku të prita mbrâm-e,
2 moj zavalli unë;
2 M'a mbaj besën që m'ke dhân-e,
2 moj zavalli unë.

O Zamaku i Bardhë

O zamaku i bardhë,
Fort u deshtme bashkë,
Kërkush nuk na dijtë,
Veç Zotyn e shpirti,

Veç Zotyn e shpirti,

E hâna qi na ndriti,

Hâna qi na ndriti:

Hâna na paditi.

Mos padit, moj hânë,

Se t'fali xherdan',

Xherdani me rushpa,

Ballin t'a pagosha;

Xherdanin me grosha,

Ballin t' pagosha;

Xherdanin me gjela,

Qi t'a vën e reja.

Kush më rri karshi karshi



O'kush më rri karshi karshi, e
se unë kam sënë marak në tÿ; e
bardhe dhe e bukur je,
e s'kam çajre pa të marrë !

O'ustallek Zoti më ka dhënë, e
si një pulë more due me u-bâ,
e në kotec more due me hi,
e tÿ burr more nuk të marr, e
lypëm e gjejëm, o i keq o,
gjejëm në mujsh, o i shtrembët o !


O'ustallek Zoti më ka dhënë, e
si një gjel mori due me u-bâ,
e në kotec mori due me hi,
e të tënë pulat me i përzie,
e pa të gjetë mori nuk të lã, e
bardhë dhe e bukur je ,
e s'kam çajre pa të marrë !



Mi Tubé Drandofille

Allegro

The musical score is written on a single staff in treble clef. It begins with a key signature of one sharp (F#) and a time signature of 2/4. The tempo is marked 'Allegro'. The score consists of several measures of music, including a section marked 'rall.' (rallentando) and another marked 'meno e' (meno mosso). The piece concludes with a double bar line and the instruction 'Dal. S. e Fine' (Da Capo e Fine).



Nji Tubë Drandofille



Oh! nji tubë drandofille po të çoj,
nji peshqesh për dashuni-aman, nji peshqesh për dashuni.

Oh! me këto lule po t'anko-
se në zemër më ke grí-aman, se në zemër më ke grí.

Oh! se ç'po m'grin e po më copton
Mikun tând shpejt n'vorr po e çon.

Oh! këtyne luleve dija hallin,
e shikoj me sy tue qá-aman, e shikoj me sy tue qá
Oh! merri erë se t'largojnë mallin
për n'e paç ndopak sevdá-aman, për n'e paç ndopak sevdá.

Oh! lot prej sývet janë tue derdh-e
E me lot due me i vajtue.

Në dyqan të Tasit-e

Në dyqan të Tasit-e

Karshi Metropolis-e

Dalin gocat e skolisë,

Nga sevdaja e dashurisë.

2

✓ Bëm, o zonjë, dhënderr-e

Se jam djal' i ëmbël-e

Se s'pi verë as pi rakí

Me një tré e kam shtëpin

Kur del hylli i sabahut

Zotrote në penxhere

Moj, Allahu ty të vraftë

Që s'më le mua të flë

2

Bëm, etj.

Veni, o veni...



Veni, o veni

Në mes të pyllit do veni

Atje ku dielli as bota nuk na shef.

Atje, ku zogjt bëjnë

Folen e dashurisë

Atje shtëpinë t'a ngrehim edhe ne.


Se ç'kändon Bilbili

Moderato

Mosso

D.C.

The image shows a musical score for the piece 'Se ç'kändon Bilbili'. It consists of three staves of music. The first staff begins with a treble clef, a key signature of one sharp (F#), and a 7/8 time signature. The tempo marking 'Moderato' is placed above the first staff. The second and third staves continue the piece, with the tempo marking 'Mosso' appearing above the second staff. The piece concludes with a double bar line and the instruction 'D.C.' (Da Capo).



Se Ç'Këndon Bilbili

Se ç'këndon bilbili puseve,
Puseve, moj lalë lule, puseve;
Se ç'ka marrë havaz' e nuseve,
Nuseve, moj lalë lule, nuseve;
Lum kush i ka,
Lum kush i do,
Lum ata bandillë
Që losin me to.

Po këndon bilbili fushave,
Fushave, moj lalë lule, fushave;
Hajde për inat të çupave,
Çupave, moj lalë lule, çupave;
Lum kush i ka,
Lum...etj..

Po këndon bilbili ferrave,
Ferrave, moj lalë lule, ferrave;
Hajde për inat të vjehrave,
Vjehrave, moj lalë lule, vjehrave.
Lum kush i ka,
Lum....etj.

Kânga e Servetit

Me sÿ të bierrun prej vajtim
ndërsa zemra m'pikon gjak,
po kujtoj kët kângë mallëngjimi,
dashurin që m' la n' marak !
Po kujtoj një besë të dhânun
prej asaj që mâ s'më flet,
që ka hikë e më ka lanun
e që i thonë emnit Servet.

Pse më le mori Servet,
pse me gojë ti mâ s'më flet,
tue e dijtë sa fort të due,
sa s'kam gojë me t'a diftue,
qysh at ditë që m' çove fjalë,
se je fevue me 'i tjetër djalë,
zemra ime po pëlset,
pse më le mori Servet!

Më ke pasë thënë se në kët botë,
s'ke për t' dashun tjetër kënd;
më ke pasë thënë se zemra jote,
rref për mue, o përnjimend !
Por ti sot mue krejt m' harrove
edhe shpinën ti m'a këthen;
mora lajmin se u-fejove,
keq për mue aspak s'të vjen !

Pse më leetj.

Me 'i kët kângë që sot t'a qita,
drit' e shpirtit, moj Servet;
Sa t'ngryse nata e t'zbardhojë drita,
emni yt kujtim tash jet !
Ti kur të ndijsh se kânga këndohet
prej gjithëkujt e në çdo vend;
me lot në sÿ do të të kujtohet
ai që të deshi përnjimend !

Pse më le.....etj.

p

Allegro Vivo

Allegro Vivo

Fine

Meno Canto

Meno Canto

D.C. e Fine




' Një Natë Hëna Po Ndrinte

Një natë hëna po ndrinte,
Ishjam vetëm pa njëri.
Oh! një qemane lark po binte,
Edhe frynte pak veri.



Për një natë desh shkallova,
U ngriç lartë me një tebe.
O përpara shtëpis të shkova,
Gjeç një vajz-c, një të ré.

Ishin Dy Kunata

Allegro



2. Fine Canto



1. D.C. e Fine



Ishin Dy Kunata

Ishin dy kunata moj zonje,
Shkojshin porsì motra;
Rusaj faqet e bardha, moj zonje
Mos t'i puthin bota.

E xhike xhike Mine
E xhike xhike Mine
E lule jasemine.
E xhike xhike loke
E xhike xhike loke
Era barziloke,


Kur m'i zbrisnje shkallët moj zonje
Dal nga dal si pata,
Hiqe ferexhenë moj zonje
Se të zuri vapa.

E xhike xhike..etj.


Fryti era e malit moj zonje,
M'i mur ment' e mija;
M'i ke flokt e gjatë moj zonje
Nuk t'i nxe shamija.

E xhike xhike..etj.

Gen. mol. Gen. kendaen syidyii



Gem Mbi Gem Këndon Bylbyli



Ndër nj' ato këdra jeshile
 nji bylbyl këndon.
Gonxhe çili drandofilli
 mbi shoqet lulzon.

Gem mbi gem këndon bylbyli
 mushun me maraz
Kueri than' se gardalinën
 t'a kan ndrye n'kafaz.

Praj, bylbyl, se mjaft lot dërdhe
 ti për dashuni.
Çou e hyp ti prap n'at çerdhe
 mos rri në vetmi.

Kndo, bylbyl, se erdh prendvera,
 çilin mal e fushë.
Si me vjollca e lule tjera
 bahçet kenkan mbushë.

Lulja e par çilte zymylá,
 por tash gjindet rrall,
Kshtu mbaroi këngën bylbyli,
 i dha fund me mall.

Tridhet Ditt e Ramazanit



519
48

Tridhet Ditt e Ramazanit

Tridhet ditt, tridhet ditt e Ramazanit,
O me të nesmen falesh Bajram ;
Aman, aman, medet aman,
O syn' i gocës porsit filxhan.

O ç'u ngriç, o ç'u ngriç në Mungalen,
O ç'nu mush zemra plot me verem.
Aman, aman, medet aman,
O syn'i gocës porsit filxhan.

O ç'u ngriç, o ç'u ngriç në Shëndëlli,
O ç'nu mush zemra me dashuri;
Aman, aman, medet aman,
O sy e vetulla porsit gajtan.

Kush e bër', kush e bëri sebeb kurben,
O me sy mos e pafit' xhenen;
Aman, aman, medet aman,
Leshrat e saja derdhur më një an.

Un. o t'ý, noj, t'ě ka. da. sntě

Allegro


Musical notation for the first system, featuring a treble clef, a key signature of one flat (B-flat), and a 2/4 time signature. The melody consists of eighth and sixteenth notes with various accidentals.

Fine

Andante

Musical notation for the second system, featuring a bass clef and a 2/4 time signature. The notation includes various note values, rests, and accidentals, with some measures containing 3/4 and 2/4 time signatures.

*D.C.
e fine*



Un o Tý, MoJ, Të
Kam Dashtë

Un o tý, të kam dashtë-e ije
Prej së vogli e fëmi.
S' të vjen keq-e ije-e me më lanë ije
E të marrish, hajde, tjetër njeri.



Sýt e mij, moJ, s'po shikjojn-e ije
Qajn' e rrjedhin si burim,
O moJ zemër-ije-e shumë duroke ije
E digju, digju, hajde bre shpirt'i im.

Djelmenin ti m'a helmoe-ije
Me zeher'n e dashuris,
Të gjith bota-ije-m'bajn të marr-e ije
QI s'hjek dor-e hajde prej ashikris.

Edhe shpirti s'po m'qetsohet-ije
Nga idhnimi qI m'ka gjetë;
Dhe kjo vjersh-e ije po t'kushtohet ije
Për kujtimin t'at, o moJ ka me mbetë.

M'a Gëzosh Shamën e Kuqe

Allegro



M'a Gëzosh Shamin e Kuqe

E m'a gëzosh shamin e kuqe,
Hej, aman.
E jasaman, moj buzë-burbuqe,
Hej, aman.

E m'a gëzosh shamin jeshile,
Hej, aman.
E jasaman, moj drandofille,
Hej, aman.

Oh! bini lulja, moj, në mur-e,
Hej, aman.
E për mas tejte u-dogja nur-e
Hej, aman.

Oh! ç'po shkëlqen vallja e Nurisë,
Hej, aman.
Oh! ti je hylli i bukurisë,
Hej, aman.

Kur Kam Kënë Nji Herë i Rí

Kur kam këné nji herë i rí,	- Lum lumi un !
Sa mirë shkova me kojshí;	" "
Me nji vajzë xûna miksi.	" "
Gjith ditën na hijeve,	" "
Gjith natën gardhijeve	" "
Tuj i ra karadyzënit;	" "
E tuj bë kokrrën e hëngut.	" "
Dikush erdh e na prigjoi;	- Mjer mjeri un !
Nina vajzën e fejoj,	" "
E fejoi në Venedik;	" "
E më xûni tjet'r. ashik.	" "
Zëmra e ëre u disprue !	" "
Jaranesha më ka lshue !	" "

Sÿn' e zî m'a ké si hÿll


Sÿn'e zî m'a ké si hÿll,
Kur m'a çilë e kur m'a mbyllë,
Si hîna qi bje në pyllë.

Ti së mirës gjêja sÿn',
Shtërngo zêmren vëni drÿn'.

Të mirën merre, merre;
Të keqen qite mbas ferre !



Të mirën në mindër;
Të keqen në qelër;
Të mirën në halí,
Të keqen në ví.

S'mirës bléj oashmângë,
S'keqes mbathi opângë !



O Llokumja me Sheqer

Allegretto



O Llokumja Me Sheqer



O llokumja me sheqer,
Kush të ka e të përkëdhel.

Tra la la, la la, la la la;

Tra la la, la la, la la la;

O llokumja në kuti,
Kush të ka të man në gji.

Tra la la,etj.

Ore djal, që pi rakinë,
Nuk e di ku e ke shtëpinë.

Tra la la,etj.

Ore djal, që pi konjakun,
Nuk e di ku e ke konakun.

Tra la la,etj.

Ore djal që e pi duhanë,
Nuk e di ku e ke dyqanë.

Tra la la,etj.

Flokt m'i Fische Krrela-Krrela

Allegretto

Flokt m'i kische krrela-krrela



Bash lezetit, moj, muhabetit,
Prune kafën-o për me pi,
Buzë m'dridhet, moj, prej kjahmetit,
Filxhani në dor' m'u ngrif.

Duert m'i kische, moj, si hakiku,
Gishtat t'u si qehlibër.
Shum hallet qi ka ashiku,
Kuer mendon se del behër.

Flokt m'i kische, moj, krrela-krrela,
E me ty m' shkoj mundi bosh.
Për në t'ardhsha, moj, më kah dera,
Zot në shpi mos vo'isha shndosh.

Molla e Vogël

Allegro



Molla e Vogël

Karajfil në kodër,
Drandofill në kodër,
Vajza e mir' në Shkodër,
molla e vogël-o.

Karajfil në bahçe,
Drandofill në bahçe,
Zemrën m'a kënaqë,
molla e vogël-o.

Karajfil në vij-e,
Drandofill në vij-e,
Emnin nuk t'a dij-e
molla e vogël-o.

Karajfil në prrue,
Drandofill në prrue,
Të marrsha për grue,
molla e vogël-o.

Karajfil në kasht-e
Drandofill në kasht-e,
Qite plakën jasht-e
molla e vogël-o.

Na të rrim-e bashk-e,
molla e vogël-o,

Hajde t'Dalim kah Pazari

Hajde t'dalim kah pazari;	-	Moj hajde na !
Vesh jelek me sumlla arit.	"	"
Un e dij se kush t'a fali;	"	"
T'a ka fale Alush Beqari.	"	"
Hajde t'dalim kah tre vidha,	"	"
Ku këndojshin shtat bylbyla,	"	"
Tre të kuq, katër jeshila.	"	"



Këngë Djepti


Nina nina, o more bir,
 Flëj se gjumi të bân mirë !
 Të bân mirë e t'rahaton
 Shtatin, bir, ty t'a pushon !
 Gjumi gjumi rahat-shumi
 Vjen me t'marrë porsî pëllumi.
 Ninë e ninë sheqer në letër
 M'u bâsh, bir, ti plak i vjetër,
 Plak i vjetër, zotni i pshtetun,
 Zotni i pshtetun e i pëvetun !
 Me të pvetë se çka me bâ,
 Çka me bâ, çka me punue,
 Plak i vjetër me urdhnue !
 Ç'po i këndon-o djalit gjumit
 Si vida qi i këndon pëllumit !
 Këndoi gjumit, këndosh i bardhë,
 Rrite, Zot, qi e ké falë !
 Ç'po i këndon-o djali djeptit,
 Si bylbyli n'gêm të plepit !
 Nina nina, more bir,
 Flëj se nâna të don mirë !
 Sa dekika qi kâ sahati
 Njashtu, djalë, t'u rritët ty shtati !
 Flëj, o djalë, se t'ka falë Zoti.
 U bâsh trim si Kastrioti !
 T'a avitë gjumi te kasnaku,
 Bir, te syni e te kapaku !
 Sa t'mirë nâna e kâ djalin
 Lur për Zotin qi na e fali !

Dashunija Coftë Mallkue

Allegro

The musical score consists of six staves of music. The first staff begins with a treble clef, a key signature of one flat (B-flat), and a 7/8 time signature. The tempo marking 'Allegro' is written above the first staff. The music is written in a single melodic line. The notation includes various note values such as eighth and sixteenth notes, as well as rests. The piece concludes with a double bar line, followed by the markings 'D.C. 4x' and 'c fine'.

Dashunija qoftë mallkue



Dashunija qoftë mallkue,
që s'më lë aspak m'u-ndalë,
tý, moj lule, pa t'i shkrue
s'pakut dy-tri fjalë,

Oh! malli yt s'më lë derman, aman !

T'kishem krahtë un i mjëri, të bijshem n'prehën tënd.

Tý moj lule, një herë të zgjodha,

e në zemër të mbáj ndry;

ndonse larg prej teje ndodha;

nenden e kam n'tý.

Oh! të shketën zemër çma ke therë, aman !

Drue po vdes un, o i mjëri, pa të marrun erë.

Mirë Dita Për Kullana

Mirë dita për kullana
Me 'i tubë pare argjâna,
Mirë mot e mirë sot,
Na ndihmo, o i lumi Zot !
Del e del Zoja e shpis,
Me kulëtë të Zotnis
Del e del e dalsh e bardhë
Sot me pare e mot me djalë.
A po del, a po shkojmë ?

Njikutu qenka 'i shej, shej mirë,
Kali kamb' bardhë
Dera e orarueme,
Zoja e nderueme
A po del, a po shkojmë ?

Njikutu qenka 'i shportë me arra,
Zojës s'shpi i u-prifët e mbara.
Njikutu qenka 'i pemë me molla
Të mira ju ardhshin fjolla, fjolla.
Njikutu qenka 'i shportë lejthija,
Flakë u-ndezët me kët derë dashtnija.
Njikutu qenkan duert si bora,
Plot me lule u-mpushët kunora
Njikutu qenka 'i arkë sheqera,
Së bardhës shpi i goftë rrit' ndera.
A po del, a po shkojmë ?



Eni të Shkojmë

Eni të shkojmë, eni të shkojmë;
në shkollë kush mos u-ndal !

Eni të shkojmë, eni të shkojmë,
nëpër fush' e mal' !

Me dalë na jashtë prej shkollavet;
te njaj diell që shkrepë sot dritorevet !

Eni të shkojmë, eni të shkojmë,
në shkollë kush mos u-ndal !

Eni të shkojmë, eni të shkojmë,
nëpër fush' e mal' !

Lojna Fmijsh



M'ká thâné nâna,

M'ká thâné baba;

Me blé fiq, me blé bukë,

Piçiçuk, moj piçiçuk !

Piçiçuk, moj piçiçuk !

Hallva sheqera,

Se na doli vera,

Vëra me lule,

Dimni me crule,

Hallvaxhija me kubure.

Zog, zog, laraman,

A m'a qit një kokërr man,

Se t'pres me tagan,

Me tagan e me sakicë,

Njikjo vajza-gomaricë !

Shoqe, shoqe, kallamoqe,

Shoqe jena, shoqe kjoqshim,

Në parriz mos u harroshim,

Kush u daftë, pika i raftë !

Pili, pilivoesa,

M'i fal dy kokrra voesa !

Dy haj vetë, dy m'i fal mue !

Kel, Kel gjysagjel,
 Kape pulën se po del !
 Lidhe për pënit,
 Preja bishtin qëniti !
 Lidhe për konopit,
 Mbaja mjekrën popit !
 Lidhe për sixhimit,
 Kapja mustakët trimit !



Gjël kokoti na u martue,
 Pulën qorre, thotë s'e due,
 Gjël kokoti po bân darsëm,
 Na ka marrun pulën qorre.
 Pula qorre, thotë s'e due,
 Gjël kokoti thotë e due !

A i rexha, piri dexha,
 Hallakate të përgjegja,
 A i dë piri dë,
 Pir' i pisk,
 Hiq' i gisht !

Age, Age, kâmë-sarage,
 Gjuej mij me kusí,
 Allah bum-lodërtí !
 Lodërtija bum e bum,
 Khixhilloja në katund.
 Gjith katundi po bân bé,
 Mori Age e kuja jé ? !

Dola në pazar, për me
blé një pulë

Dola në pazar, për me blé një pulë,
Pula bëni voen, gjeli na duet kënuet.

Dola në pazar, për me blé një rikë,
Rika bëni ngëkë, ngëkë,

Pula bëni voen, gjeli na duet kënuet.

Dola në pazar me zënë një nusë.

Nusja thotë: merrëm rue !

Çika thotë: merrëm rue !

Kau thotë: zënë rue !

Delja thotë: qethëm rue !

Lopa thotë: milëm rue !

Pata bëni: vëkë, vëkë !

Rika bëni: ngëkë, ngëkë !

Pula bëni voen,

Gjeli na duet kënuet.



Hovi i Madh, Hovi i Vogël

Hovi i madh, hovi i vogël,
Shkon e vjen nëpër Shkodër,
Rê, rê, zoja rê,
M'a qit diellin sa t'fléj
Nën mard, usta Bajram;
Nën fik, Kol ashik,
Nën kumbull, kokërr sumbull;
Ulu (N....) në saxhade,
Pije kafën, limonade;
Hopa ! hopa !
Me simita e me kajrakë,
Hopa ! hopa !

Oh ! N'at fushë të mejdanit

2 Oh! N'at fushë t'mejdanit

Shkon e vjen dyrnjaja,

2 Sielle kryet prej xhamit

Digjet fukaraja

2 Oh! Mori shtat-selviqe,

2 Shikjo në qitabe,

2 Fol me gojë, Nuriqe,

Se ke shumë sevape

2 Oh! Shka po t'thot' jot'an-e



Di'e nëpër di'-e ?

2 Ven dallfes m'njen'an-e

N'daç me xan'ashik-e



Vaj, si Kenka Bâ Dyrnjaja




Vaj, si kenka Bâ Dyrnjaja

2 Vaj, si kenka bâ dyrnjaja
Mos me t'u bâ me kenë gjallë
Un, o i mjeri, fukaraja,
Paskam ndodhun-o pa ikball.

2 Gjith prej hallit, prej sikletit
M'u bâ borxh me dalë me tretë
Mora rrugat e gyrbetit,
Selametin për m'e gjetë.

2 Rrugën mar' me lot e lava
Der sa mrrinë jabankhi
Zemra m'tha gjithmonë se kjava,
Qysh i vogël-o der n'pleqni.




Metelikun t'a Kam Falë

Allegretto



rit. *meno.*



piu mosso



mosso




D.C. 3x e Fine

Metelikun t'a Kam Falë

Metelikun t'a kam falë,
E bej, o'man aman !
Ti ala s'e ke harxhue, aman-e
2 Blej kalem e mereqep-e,
Gjylfet tueja me i shkrue,
E sa e bukur je.


Të kam thirr' nji nat' me bujt',
E bej, aman aman !
M'a don hatri me m'ardhë, aman-e
Ti kujton se due me luejt-e,
2 Maraku në ty m'ka xanë,
E sa e bukur je.

N'at dekik qi t'dalin hana,
E bej, aman aman !
Dalim bashkë e rrim në fresk, aman-e
Drue qyqja se m'dikton nana,
2 T'bâj me dijt me 'i guralec,
E sa e bukur je.



Karajfiinat si ke Sirodra

Valzer lento



Karajfilat qi ka Shkodra



Karajfilat qi ka Shkodra,
Medet o kund nuk janë.
Ganxhe t'mdhaja, ganxhe t'vogla,
Me erë mbushin dyrnjan, aman, aman.
Ato ganxhe s'm'i prek' dora,
Medet o kan zianë.


Drandofillja lypite hije,
Medet o për me çil' hije,
Gjetht-i dalin' fite hije,
Medet o ç'erë të mir', aman aman.
S'gjindet kush me t'u përzi-e,
Medet, moj drandofill

Karangjyli kaq i bukur,
Medet o por s'ka erë.
Me i a prek' gjethin me pupul,
I bishin t'gjith me 'i her', aman aman.
Me i a prek' gjethin me pupul,
Aman, dorën ç't'a t'herë.

Darsma e Iriqit



Thonë se bāni iriqi darsēm
rring, rring e xhing.
Po martote djalë mā t'mirin,
rring, rring e xhing.
Kūr duel nusja në çardak
rring, rring e xhing.
Çka me pá hatá me sy,
rring, rring e xhing.
Kah pō mbushte thnegla uj,
rring, rring e xhing.
Kah pō shite pleshti oborrin,
rring, rring e xhing.
Kah po bān bolla jeprakun,
rring, rring e xhing.
Kah po i vën mica saxhakun,
rring, rring e xhing.
Kah po i mbate mini pishen,
rring, rring e xhing.
Kukuvacat bājshin ilafe,
rring, rring e xhing.
Kaçamijt pō pijshin kafe.
rring, rring e xhing.



Kānga e Pilafit

Urdhnoni, zotni, e merrni

Pilafin taim e keni !

Luga, luga do t'a çoni

Na don hatri t'a mbaroni !

Zotnij jeni e zotnij kjofshi

Për të mirë-o na urdhnoshi,

Zoja t'ua na i gëzoshi !



A s'i a themi njëzë.....:

A s'i a themi njëzë, të na bënen dyzë:

Dy cica i ka vasha,
Zën'e hollë e ka bilbili,
Që na këndon Prillë,
Prillë dhe gjith Majnë.

A s'i a themi dyzë, të na bënen trizë:

Tri këmbë perustija,
Dy cica i ka vasha,
Zën' e hollë e ka bilbili,
Që na këndon Prillë,
Prillë dhe gjith Majnë.

A s'i a themi trizë, të na bënen katër:

Katër sisë i ka lopa,
Tri këmbë perustija,
Dy cica i ka vasha,
Zën' e hollë e ka bilbili,
Që na këndon Prillë,
Prillë dhe gjith Majnë.

A s'i a themi katër, të na bënen pesë:

Pesë gishtër i ka dora,
Katër sisë i ka lopa,
Tri këmbë perustija,
Dy cica i ka vasha,
Zën' e hollë e ka bilbili,
Që na këndon Prillë,
Prillë dhe gjith Majnë.

A s'i a themi pesë, të na bënen gjashtë:

Gjashtë brirë i ka dreri,
Pesë gishtër i ka dora,
Katër sisë i ka lopa,
Tri këmbë perustija,
Dy cica i ka vasha,
Zën'e hollë e ka bilbili,
Që na këndon Prillë,
Prillë dhe gjith Majnë.

A s'i a themi gjashtë, të na bënen shtatë:

Shtatë vëra i ka koka,
Gjashtë brirë i ka dreri,
Pesë gishtër i ka dora,
Katër sisë i ka lopa,
Tri këmbë perustija,
Dy cica i ka vasha,
Zën'e hollë e ka bilbili

Që na këndon Prillë,
Prillë dhe gjith Majnë, ..etj.

PERIBAUTJA

	Faqe	
Hymni i Flamurit	1	
Shqipnija	2	"
Shqipnis së Robnueme	3	"
Atdheu	4	"
Hymni i Djelmënis Shqiptare	5	"
Rueje, o Zot Atdhën !	6	"
Porsi Fleta	7	"
Të Gjithë Ne o Djema	8	"
Kuq e Zi	9	"
Malli për Atdhë	10	"
Nji Fatosi	11	"
Gjuha Shqipe	12	"
Lamtumirë	13	"
I Tretuni	14	"
Bagëti ja Në Kullosë	15	"
Krënija	16	"
Dimni	17	"
Foshnja me Buzë në Gaz	18	"
Natë e Qetë	19	"
Kangë	20	"
A je Brymë, Moj, a je Borë	21	"
Dashnuer t'u bëna	23	"
Sa Bukur Rrojshim	24	"
Mueji i Majit	25	"
Kënga e Detit	27	"
Nën një Mal e Ndër dy Ara	28	"
Eminja	29	"
Oh! Po të Pres të Dega e Fikut	31	"
O Zamaku i Bardhë	32	"
Kush më Biri Karshi Karshi	33	"
Nji Tubë Drandofille	35	"
Në Dyqan të Tasit-e	36	"
Vemi, o Vemi	37	"
Se ç'Këndon Bilbili	39	"
Kënga e Servetit	40	"
Sa e Bukur Na Doli Nusja	41	"
Një Natë Hëna Po Ndrinte	43	"
Ishin Dy Kunata	45	"
Gem Mbi Gem Këndon Bylbyli	47	"
Tridhet Ditt e Ramazanit	49	"
Un o Ty, Moj, Të Kam Dëshirë	51	"

	Page
M'a Gëzosh Shamin e Kuqe	53
Kur Kam Kënë Nji Herë i Ri	54
Syn'e Zi m'a Ke si Hÿll	55
O Llokumja, me Sheqer	57
Flokt m'i-Kishe Krrela-Krrela	59
Molla e Vogël	61
Hajde t'Dalim Kah Pazari	62
Këngë Djepi	63
Dashunija Qoftë Mallkue	65
Mirë Dita Për Kullana	66
Eni të Shkojmë	67
Lojna Fmijsh	68
Dola Në Pazar për me Blë Nji Pulë	70
Hovi i Madh, Hovi i Vogël	71
Oh! N'at Fushë të Mejdanit	73
Vaj, Si Kenka Bâ Dyrnjaja	75
Meteliku t'a Kam Falë	77
Karajfilat Qi Në Shkodra	79
Darsma e Iriqit	80
Kënga e Pilafit	81
A s'i a Themi Njëzë...	82
Përmbajtja	84